

Programi Fulbright për Studiues të Huaj (Fulbright Visiting Scholar Program) është një program post-doktoral që zgjat tre deri në gjashtë muaj, dhe u jep mundësi studiuesve të rinj apo me më shumë përvojë, lektorëve të universitetit dhe ekspertëve nga institucione akademike dhe kërkimi, të bëjnë kërkime dhe/ose të japin mësim në një universitet në Shtetet e Bashkuara.

Aplikimet janë të hapura për të gjitha fushat e studimit [2022 Fulbright Visiting Scholar](#) .

Ju lutemi përzgjidhni me kujdes disipinën e duhur dhe fushën primare të specializimit nga lista që ofrohet në formularin e aplikimit.

Bursat zakonisht zgjasin tre deri në gjashtë muaj në një universitet në Shtetet e Bashkuara. Kandidatët janë të detyruar të kthehen në Shqipëri për të paktën dy (2) vjet në përfundim të programit.

- Kërkesat për Kualifikim
- Aplikantët duhet të jenë qytetarë të Republikës së Shqipërisë
- Aplikantët duhet të kenë gradën Doktor ose të jenë kandidatë për gradën Doktor në fushën e tyre të studimit
- Aplikantët duhet të kenë të paktën pesë vjet përvojë mësimdhënie dhe/ose kërkimore në një universitet shqiptar ose institucion tjetër kërkimor
- Aplikantët duhet të kenë një nivel të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (ekuivalente të nivelit B2; rezultatet e provimit të TOEFL nuk janë të detyrueshme në momentin e aplikimit)
- Aplikantët duhet të kualifikohen për të marrë vizë J-1
- Aplikantët duhet të kenë rekorde të mira shëndetësore

Per me shume informacion, te interesuarit mund te klikojne ne <https://al.usembassy.gov/education-culture/educational-exchange-programs/fulbright-programs/>

Per pyetje te tjera mund te kontaktojne edhe ne kete adrese email: EducationandCultureTirana@america.gov ose te regjistrohen [here](#) për të ndjekur seancat informative në lidhje me programin të ofruara nga stafi i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun.

Programi Fulbright për Studentë të Huaj (Fulbright Foreign Student program) është një program një ose dy vjeçar për profesionistë të rinj dhe ata që kanë përfunduar studimet, të interesuar të ndjekin studime në nivelin Master në Shtetet e Bashkuara.

Aplikimet janë të hapura për të gjitha fushat e studimit. [2022 Fulbright Student Program](#)

Per vitin akademik 2021-2022, në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit për Programin e Shkëmbimit Akademik Fulbright, Qeveria e Republikës së Shqipërisë, firmosur më 25 shtator 2019, do te financoje aplikantet e perzgjedhur në nje nga fushat e mëposhtme:

1. Edukim
2. Inxhinieri
3. Shkencat e Natyrës
4. Histori
5. Gjuhësi

6. Shkenca Kompjuterike/Teknologji Informacioni
7. Administrim Publik

Bursat zakonisht zgjasin një deri në dy vjet në një universitet në Shtetet e Bashkuara për të ndjekur studime për gradën Master. Kandidatët janë të detyruar të kthehen në Shqipëri për të paktën dy (2) vjet në përfundim të programit.

Kërkesat për Kualifikim

- Aplikantët duhet të jenë qytetarë të Republikës së Shqipërisë.
- Aplikantët duhet të kenë të paktën një diplomë të nivelit Bachelor nga një program studimi me kohë të plotë katër vjeçar (ose diplomë të programeve tre + një ose tre + dy, sipas sistemit të Bolonjës).
- Aplikantët duhet të kenë të paktën dy vjet përvojë profesionale pune në fushën e studimit dhe të shfaqin aftësi udhëheqëse
- Aplikantët duhet të kenë një nivel të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (ekuivalente të nivelit B2; rezultatet e provimit të TOEFL nuk janë të detyrueshme në momentin e aplikimit.)
- Aplikantët duhet të kualifikohen për të marrë vizë J-1.
- Aplikantët duhet të kenë rekorde të mira shëndetësore.

Per me shume informacion, te interesuarit mund te klikojne

ne <https://al.usembassy.gov/education-culture/educational-exchange-programs/fulbright-programs/>

Per pyetje te tjera mund te kontaktojne edhe ne kete adrese

email: EducationandCultureTirana@america.gov ose te regjistrohen [here](#) për të ndjekur seancat informative në lidhje me programin të ofruara nga stafi i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun.

2022-2023 Programi Hubert H. Humphrey

Programi Hubert H. Humphrey dërgon në Shtetet e Bashkuara profesionistë që janë në mes të karrierës së tyre profesionale dhe me potencial udhëheqës, **për një program dhjetë muaj, të nivelit pasuniversitar, me kurse akademike dhe aktivitete të zhvillimit profesional por që nuk përfundon me diplomë.** Kandidatët nominohen në bazë të potencialit për udhëheqje dhe përkushtim në shërbim publik.

Kategoritë dhe Fushat Specifike të Programit

Kapacitete Njerëzore dhe Institucionale: Zhvillim Ekonomik, Financë dhe Bankë; Analizë të Politikave Publike dhe Administratim Publik; Politika dhe Menaxhim Teknologjik; Menaxhim të Burimeve Njerëzore

Të drejtat dhe Liritë: Komunikim dhe Gazetari; Liria Ndërombëtare Fetare; Drejtësi dhe Të Drejtat e Njeriut; Politika dhe Parandalimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore

Toka të Qëndrueshme: Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Burime Natyrore, Politikat Mjedisore dhe Ndryshimet Klimaterike, Planifikim Urban dhe Rajonal

Komunitete në rritje: Sëmundjet Ngjitëse dhe Infektive; Politika dhe Menaxhim të Shëndetit Publik; Politika dhe Parandalim të HIV/AIDS; Edukimi, Parandalimi dhe Trajtimi i Abuzimit me Lëndët Narkotike; Administrim, Planifikim dhe Politika të Arsimit; Administrimi i Arsimit të Lartë; Mësimdhënie e Gjuhës Angleze si Gjuhë e Huaj;

Programi Humphrey zgjat dhjetë muaj. Kandidatët janë të detyruar të kthehen në Shqipëri për të paktën dy (2) vjet në përfundim të programit.

Kriteret e Përzgjedhjes:

- Aplikantët duhet të jenë qytetarë të Republikës së Shqipërisë
- Aplikantët duhet të kenë të paktën një diplomë të nivelit Bachelor nga një program studimi me kohë të plotë katër vjeçar (ose diplomë te programeve tre + një ose tre + dy sipas Sistemit të Bolonjës).
- Aplikantët duhet të jenë të punësuar në Shqipëri
- Aplikantët duhet të kenë të paktën pesë vjet përvojë profesionale pune në fushën e studimit
- Aplikantët duhet të kenë një nivel të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (ekuivalente të nivelit B2; Përfshini rezultatet e provimit të TOEFL ose IELTS nëse janë të vlefshme)
- Aplikantët duhet të demonstrojnë aftësi lidhëse dhe përkushtim në shërbimin publik
- Aplikantët duhet të kualifikohen për të marrë vizë J-1.
- Aplikantët duhet të kenë rekorde të mira shëndetësore.

Të gjithë aplikantët e interesuar duhet të plotësojnë online formularin Humphrey. Klikoni [2022-2023 Humphrey program](#) për formën e aplikimit online.

Për informacion të mëtejshëm kontaktoni: Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, Ambasada Amerikane, Tiranë me email EducationandCultureTirana@America.gov ose regjistrohuni [here](#) për të ndjekur seancat informative në lidhje me programin të ofruara nga stafi i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun.